

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Marrëdhëniet SHBA-Turqi përballen me çështje të nxehta, Erdogan merr komplimentet e Trumpit por jo a vionët F-35 - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/marredheniet-shba-turqi-perballen-me-ceshtje-te-nxehta-erdogan-merr-komplimentet-e-trumpit-por-jo-avionet-f-35/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 12:10:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 12:10:42 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	26a8ec36cc62d08d2db12196ab58be603bf864f6d838e9b573fb88ea01ef17ac
TEKSTI	045baec0e8cfe164f8f07f4659d0946dc28338ae4919afda2f442a086870ada3
PAMJA	9db6ad7987d1dd4b849f5b7bfcc86fc3810833ddc3a3c6592cc7e5152f3feb2c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4dbfd4c45dc062f95d14288c7f354330cfc8b811b10c5e3dd80a28ce920b28cb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ff908387fa0a76615844b1eb2f3b6d25afb991cdfafb8197b5cbb8a7a203d8c9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4dbfd4c45dc062f95d14288c7f354330cfc8b811b10c5e3dd80a28ce920b28cb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Donald Trump Vlora Hyseni Sali Berisha Policia e Tiranës Kosova

BOTA

Marrëdhëniet SHBA-Turqi përballen me çështje të nxehta, Erdogan merr komplimentet e Trumpit por jo avionët F-35

24 Shtator 2026 | 14:10

Presidenti amerikan Donald Trump ka shprehur vlerësime të forta për homologun turk Rexhep Tajip Erdogan gjatë takimeve në Nju Jork, duke e cilësuar atë si një lider të fortë dhe një mik.

Megjithatë, përtej deklaratave miqësore, çështjet kryesore që Ankara ja kërkon të zgjidhë me Uashingtonin mbeten ende të hapura.

Në qendër të tyre janë rikthimi i Turqisë në programin e avionëve luftarakë F-35 dhe furnizimi me motorë për avionët luftarakë turq KAAAN.

Sipas raportimeve nga mediat e huaja, Ankara mbetet jashtë programit F-35 për shkak të blerjes së sistemit rus S-400, që ka sjellë sanksione amerikane sipas ligjit CAATSA.

Deri tani, nuk ka pasur një njoftim për heqjen e këtyre kufizimeve. Në të njëjtën kohë, Turqia ka konkretizuar një marrëveshje të rëndësishme ekonomike me SHBA-në.

Turkish Airlines ka nënshkruar një marrëveshje për blerjen e 100 avionëve Boeing 737-8, me mundësi për 50 avionë të tjerë të familjes Boeing 737 MAX.

Erdogan dhe Trump nuk zhvilluan një takim të veçantë dypalësh në Nju Jork, ndërsa çështjet më të ndjeshme të marrëdhënieve mes dy vendeve duket se mbeten jashtë diskutimeve publike.

Mes tyre janë S-400, programi F-35 dhe motorët amerikanë për KAAAN.

Edhe ambasadori amerikan në Turqi, Tom Barrack, e përshkroi marrëdhënien mes dy liderëve si të karakterizuar nga respekt dhe harmoni, duke theksuar njëkohësisht se çështja e sanksioneve CAATSA kërkon ende kohë.

Kështu, ndërsa retorika mes Trumpit dhe Erdoganit mbetet miqësore, marrëdhëniet amerikano-turke vazhdojnë të përballen me çështje të rëndësishme strategjike që ende nuk kanë gjetur një zgjidhje.

LAJMI I FUNDIT

14:04 Frikë nga dronët rusë nga Mesdheu, Brukseli në gatishmëri

14:03 Berisha për rastin Hyseni: Siguria kombëtare është shembur

13:43 Pas 3 orësh debate dhe bllokim i foltores, Kuvendi kalon në votim

13:40 Qeveria italiane mohon SHPËRNDAJE
raportet për sulme me dronë
ARTIKULLIN rusë: Nuk morëm asnjë paralajmërim

13:35 Plagosje me armë zjarri në Lezhë, i riu transportohet drejt Traumës në Tiranë

13:31 Anthropic: Claude identifikoi një sistem të ri enzimatik

TESTIM

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

BOTA

Anthropic: Claude identifikoi një sistem të ri enzimatik

Kompania amerikane e inteligjencës artificiale Anthropic ka njoftuar se modeli i saj Claude ka identifikuar në mënyrë autonome një sistem enzimatik të pakarakterizuar më parë,...

13:31 | 24/09/2026

BOTA

Holanda do të investojë në armë lazer për t'iu kundërvënë droneve

Holanda do të investojë në armë lazer të dizajnuara për të çaktivizuar dronët e armikut, raportuan mediat holandeze. Sekretari i Shtetit për Mbrojtjen, Gijs Tuinman,...

13:10 | 24/09/2026

BOTA

Trump vlerëson Erdoganin: Është një njeri i fortë, nuk mund të luash me të

Presidenti amerikan Donald Trump shprehu vlerësime të larta për Presidentin Recep Tayyip Erdoğan gjatë një takimi me liderë të Lindjes së Mesme, duke e cilësuar...

09:39 | 24/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni
Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.